

Thirrje e hapur për aplikim për projekte

Kosovo 2.0 bashkë me partnerët e [Reporting Diversity Network 2.0](#) kanë hapur thirrjen për aplikime për projekte që synojnë të kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes dhe të përmirësojnë përfaqësimin e diversitetit.

Kjo thirrje është pjesë e projektit Reporting Diversity Network 2.0 (Rrjeti për Raportimin e Diversitetit 2.0), i themeluar me synimin që të ndikojë në mënyrë efektive në mënyrën e përfaqësimit mediatic të etnisë, religjionit dhe gjinisë në Ballkanin Perëndimor. RDN 2.0 synon të bëjë më aktiv rolin e shoqërisë civile në kundërshtimin e narrativave përçarëse dhe në zëvendësimin e këtyre narrativave me diskurs pozitiv duke kontribuar kështu në vlerën e fqinjësisë së mirë dhe respektit ndaj diversitetit shoqëror.

Qëllimi i përgjithshëm i thirrjes për propozime është të rrisë efektivitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) në ndërveprimin me mediat me qëllim që të reduktohen stereotipet dhe imazhet negative për të tjerët.

Qëllimet specifike të kësaj thirrjeje për propozime janë:

- të fuqizojë pozicionin e OShC-ve vendore në mbrojtjen e të drejtave mediale të përfituesve të tyre;
- të ofrojë mundësi për OShC-të vendore për të ndikuar në perceptimet e publikut;
- të rrisë numrin dhe cilësinë e mesazheve të pëçuara tek audienca;
- të përmirësojë praninë e çështjeve që lidhen me të drejtat e grave dhe ato të minoriteteve në media;
- të rrisë vetëdijen dhe të kontribuojë në perceptimet pozitive për të tjerët si dhe në tolerancën dhe gjithëpërfshirjen në rajon;

Llojet e aktiviteteve që janë të pranueshme për financim (radha është e hapur dhe mund të përfshijë aktivitete të tjera të projektit për sa kohë që ato kontribuojnë në qëllimet e lartpërmendura):

- a) Fushata avokuese dhe ndërgjegjësuese;
- b) Prodhimi i përmbajtjes mediatike;
- c) Fushata kundër narrativave të urrejtjes në sferën publike;
- d) Krijimi i web-portaleve specifike që mundësojnë përfshirjen e qytetarëve, qasjen në informacion dhe debatin publik;
- e) Konsultime, tryeza dhe takime me hisedarët relevantë vendorë;
- f) Lehtësimi i dialogut për politika me hisedarët relevantë (p.sh. partitë politike, zyrtarët lokalë, komuniteti i ekspertëve, mediat).

Të gjitha aktivitetet duhet të zhvillohen në Kosovë.

Projektet duhet të realizohen brenda një periudhe 6-mujore.

Buxheti i përgjithshëm për programin është 27500 euro. Siç është paraparë në Program, Kosovo 2.0 do të mbështesë 5 projekte, ndërsa **grantet për organizatë do të variojnë nga 3000 EUR deri në 8000 EUR.**

OShC-të që i përgjigjen kësaj thirrjeje duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë të regjistruara dhe të kenë shlyera të gjitha detyrimet tatimore;
- të kenë përvojë të dëshmuar në fushën e diversitetit dhe/ose gjuhës së urrejtjes;
- të jenë drejtpërdrejtë përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit;
- të mos kenë një llogari bankare të bllokuar;
- të mos jenë përfituese të fondeve të Programit të Komisionit Evropian për Shoqërinë Civile dhe Media 2018-2019 (CIVIL SOCIETY FACILITY AND MEDIA PROGRAMME 2018-2019), zërat e buxhetit: **BGUE-B2018-22.020401** dhe **BGUE-B2019-22.020401**
- **Organizatat mund të paraqesin vetëm një projekt-propozim sipas këtij Programi si aplikant ose si partner;**

Mirëpresim aplikime nga lloje të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile: organizata në komunitet (grassroots), organizata anëtare të rrjeteve në shkallë më të gjerë që veprojnë në nivel kombëtar ose rajonal, media të themeluara si OShC etj.

Partneriteti me mediat vendore do të konsiderohet si një përparësi dhe do të sigurojë pikë shtesë.

Një trajnim një-ditor mbi rregullat dhe procedurat për zbatimin e granteve të BE-së do të organizohet për aplikantët e përzgjedhur. Trajnimi do të përfshijë tema të tilla si: menaxhimi i projektit, rregullat e vizibilitetit, raportimi financiar, etj.

Gjithashtu, aplikantëve të përzgjedhur do t'u sigurohet mbështetje mentorimi për t'u ndihmuar në realizimin e fushatave mediatike kreative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut si dhe në menaxhimin e aktiviteteve të projektit.

Ftojme të gjitha organizatat e interesuara të plotësojnë formularin e aplikimit si dhe formularin e buxhetit. **Aplikimi duhet plotësuar në gjuhën angleze.**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është: 21 shkurt 2022, ora 17:00.

Ju lutemi dorëzoni aplikimet tuaja, duke përfshirë formën e aplikimit, formën e buxhetit, certifikatën e regjistrimit, vërtetimin tatimor në: <eumediagrants@ktwopointzero.com>

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni <eumediagrants@ktwopointzero.com> deri më **7 shkurt**.

Kriteret e vlerësimit:

- 1) Përputhshmëria midis propozimit dhe qëllimeve të Thirrjes për Propozime dhe rëndësia e propozimit në përmbushjen e nevojave të grupeve të synuara; (30 pikë)
- 2) Efektiviteti dhe realizueshmëria e projektit – lidhja e qartë dhe konsistencë ndërmjet qëllimeve, rezultateve të parashikuara, aktiviteteve të propozuara dhe strategjisë; (20 pikë)
- 3) Kapaciteti financiar dhe operacional për t'i realizuar aktivitetet e propozuara në mënyrë të pavarur – do të duhet të dëshmohet një nivel elementar i kapacitetit organizativ dhe menaxherial; (20 pikë)
- 4) Ndikimi dhe përfshirja e hisedarëve relevantë – propozimet duhet të jenë të realizueshme dhe treguesit duhet të jenë objektivisht të verifikueshëm dhe të matshëm (numri i qytetarëve që do të përfshihen në projekt); (10 pikë)
- 5) Përfshirja e grupeve të cenueshme dhe përfshirja e çështjeve gjinore – propozimet duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve të cenueshme; (5 pikë)
- 6) Qëndrueshmëria – propozimet duhet të tregojnë qartë se si do të jenë të qëndrueshme pas përfundimit të projektit. (5 pikë)
- 7) Buxheti dhe efektiviteti i kostos së projektit – raporti ndërmjet kostos së parashikuar dhe rezultateve të pritura duhet të jetë i kënaqshëm (10 pikë)

Komisioni vlerësues do t'i kushtojë vëmendje mbulueshmërisë gjeografike dhe tematike të granteve duke respektuar parimet e mundësive të barabarta dhe ato të gjithëpërfshirjes.

Shënim: Kosovo 2.0 mund të kërkojë dokumentacion shtesë jo më vonë se tetë ditë pas pranimit të projekt-propozimit.

Aplikimet do të shqyrtohen nga një Komision i pavarur ekspertësh nga rajoni.